

## THIRRJE PËR APLIKIM

Prishtinë, 19/10/2023  
Departamenti për Demokratizim

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka kënaqësinë t'ju ftojë që të aplikoni për trajnimin **Raportimi i Gjykimit të Simuluar** që do të mbahet më 1 dhe 2 nëntor 2023 në Gjykatën Themelore Prishtinë.

Trajnimi do të pasohet nga një punëtori përmbyllëse që do të mbahet më 3 nëntor 2023, në *Hotel Swiss Diamond* në Prishtinë.

Qëllimi i këtij trajnimi interaktiv është të ju sigurojë gazetarëve të rinj dhe aspirantë nga të gjitha komunitetet në Kosovë dhe përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë përvojë të dorës së parë në raportimin gjyqësor. Gjyqtarët, prokurorët dhe zëdhënësit e gjykatave do të udhëzohen se si t'ju sigurojnë informacion gazetarëve pa e kompromentuar aspektin e privatësisë ose rrezikuar procedurat gjyqësore. Në anën tjetër, gazetarët e rinj aspirantë dhe studentët e drejtësisë do të udhëzohen rreth praktikave më të mira për mbledhjen e informacionit dhe komunikimin me zyrtarët e drejtësisë dhe anasjelltas. Punëtorja përmbyllëse e 3 nëntorit do të shërbejë si platformë për të diskutuar rreth mësimëve të nxjerra, nga ku do të nxjerrën përfundime dhe rekomandime.

Trajnimi do të realizohet nga dy ekspertë ligjor të njohur vendas të medias, në bashkëpunim me Kryetaren e Gjykatës Themelore dhe Zëvendëskryetarin, si dhe Kryetarin e Prokurorisë Themelore dhe një prokuror.

Ftojme studentet e studentët e rinj, nga të gjitha komunitetet, të departamentit të gazetarisë dhe gazetarët aspirantë si dhe studentët e drejtësisë në mbarë Kosovën të aplikojnë.

Transporti për në Pallatin e Drejtësisë dhe kthimi prapa është i siguar nga hapësira përball Zyrës Qendrore të OSBE-së. Trajnimi do të mbahet në gjuhën shqipe me përkthim të siguar në gjuhën serbe.

Ju lusim që ti drejtoheni përmes postës elektronike (e-mail) znj. [arlinda.osmanaj@osce.org](mailto:arlinda.osmanaj@osce.org) ose përmes telefonit në: +383 49 950 209, duke e shprehur vullnetin tuaj për të marrë pjesë në trajnim për Raportimin e Gjykimit të Simuluar më së voni deri më 24 tetor, ora 16:00.

\*Procesi i aplikimit do të mbetet i hapur deri në plotësimin e kapacitetit të pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit pritet të angazhohen në mënyrë aktive në të gjitha aspektet e trajnimit dhe ne inkurajojmë fuqishëm diskutimet dhe shkëmbimin e mendimeve. Ne vlerësojmë shumë respektin e ndërsjellë për mendimet dhe prejardhjet e ndryshme të njëri-tjetrit.

Programi do ti kushtoj theks të rëndësishëm aktiviteteve të rrjetëzimit dhe promovimit të raporteve midis pjesëmarrësve, andaj pritet angazhim i plotë nga të gjithë pjesëmarrësit.